

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje UPS për nevoja të Agjencisë së Inteligjencës
Financiare” .**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) Furnizues me energji të pandërprerë
31154000-0

**VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 3,572,000 (tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë
e dy mijë) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2,
pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara
në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e e
kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, eksperti i fushës ka hartuar kriteret teknike
për kualifikim ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues
Agjencia e Inteligjencës Financiare janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari
përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për
Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së
Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të ndryshuar: citojme
Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga
ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të
prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për
pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend
të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës
të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në
rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme."

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit duhet të ketë të punësuar stafin e tij teknik si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) specialist të fushës elektrike/elektroteknike/elektronike
- Të paktën 1 (një) person të trajnuar ose certifikuar për instalimin, konfigurimin dhe/ose mirëmbajtjen e sistemeve UPS.

Operatori ekonomik në lidhje me stafin e sipërkërkuar duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Kontratë pune të vlefshme ose kontratë bashkëpunimi;
- CV
- Çertifikatë/Diplomë/Dëshmi kualifikimi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

***Shënim:** Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

Shënim: Kriteri Nr.2.3.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të nenit të 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 “Kërkesa të veçanta

për kontratat e mallrave”, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimi 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” dhe Urdhërit nr.99, datë 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Ky kriter konsiderohet i nevojshëm për të garantuar realizimin korrekt të furnizimit dhe shërbimeve që lidhen me instalimin, konfigurimin, testimin dhe vënien në punë të pajisjeve UPS. Duke qenë se objekti përfshin edhe një UPS me fuqi 60 kVA, me furnizim trefazor, bankë baterish dhe elementë të tjerë elektrikë të sistemit, kërkohet angazhimi i një specialisti me formim teknik të përshtatshëm, i cili të sigurojë kryerjen e këtyre proceseve në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara.

Në lidhje me 1 (një) person të trajnuar ose certifikuar për instalimin, konfigurimin dhe/ose mirëmbajtjen e sistemeve UPS është gjykuar të kërkohet për të garantuar që instalimi, konfigurimi dhe vënia në punë e pajisjeve të realizohen nga personel që disponon njohuri specifike mbi sistemet UPS dhe mënyrën e funksionimit të tyre. Specifikimet teknike parashikojnë testim funksional, testim me ngarkesë, testim të baterive dhe, për UPS-in 60 kVA, testim të bypass-it dhe vënie në punë të sistemit. Për këtë arsye, disponimi i të paktën një personi të trajnuar ose certifikuar në këtë fushë krijon siguri më të lartë për realizimin korrekt të këtyre proceseve. Personi i kërkuar mund të jetë i njëjti me specialistin e kërkuar në pikën . Kërkimi i diplomave dhe certifikatave garantojnë kualifikimin e personelit të angazhuar në këtë proces..Lidhur me kërkesën që AK jo domosdoshmërisht kërkon që stafi i ofertuesit të mundshëm ekonomik të jetë i qëndrueshëm por mund të kontraktohen nga operatorët ekonomikë të interesuar për realizimin e objektit të prokurimit. Ky përcaktim në këtë mënyrë është bërë duke mbajtur parasysh parimet dhe vetë qëllimin e ligjit të prokurimit sikundër janë nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë sigurimi i një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; si edhe sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë dhe ti provojnë Autoritetit Kontraktor se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter kërkohet për të garantuar që pajisjet UPS të ofruara të jenë në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat funksionale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Paraqitja e dokumentacionit teknik zyrtar të prodhuesit siguron që pajisjet e ofruara të disponojnë karakteristikat, performancën, kapacitetin dhe funksionalitetet e kërkuara, duke garantuar përshtatshmërinë e tyre me nevojat e Autoritetit Kontraktor dhe funksionimin e duhur të sistemit pas instalimit dhe vënies në punë. Dokumentacioni për autonominë dhe përputhshmërinë e

baterive garanton gjithashtu që konfigurimi i ofruar të sigurojë furnizimin e kërkuar me energji dhe autonominë e përcaktuar në specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë tabelën zyrtare të autonomisë (Battery Runtime Table) ose llogaritjen e dimensionimit të autonomisë për konfigurimin e ofruar, të lëshuar nga prodhuesi i UPS-it vetëm në rastet kur ky informacion nuk specifikohet në katalogë / broshurë / skedë teknike të prodhuesit.

Argumentimi: Ky kriter është i nevojshëm për të verifikuar që UPS-i i ofertuar përmbush autonominë e kërkuar sipas konfigurimit të propozuar. Paraqitja e tabelës zyrtare të autonomisë ose e llogaritjes së dimensionimit, të lëshuara nga prodhuesi, garanton vërtetësinë e të dhënave teknike dhe mundëson një vlerësim objektiv të përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike. Ky kriter kërkohej pasi katalogu ose datasheet-i i prodhuesit paraqet karakteristikat e përgjithshme teknike të modelit të UPS-it, por jo domosdoshmërisht përfshin tabelën zyrtare të autonomisë (Battery Runtime Table) ose llogaritjen e dimensionimit për konfigurimin konkret të ofruar. Paraqitja e këtij dokumenti mundëson verifikimin e autonomisë reale të sistemit sipas kapacitetit të baterive dhe ngarkesës së kërkuar, duke garantuar që konfigurimi i ofertuar përmbush kërkesat funksionale të autoritetit kontraktor dhe duke shmangur deklaratimet e pabazuara ose interpretimet e ndryshme të të dhënave teknike

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë”** / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

***Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar me mall cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.*

ISO 9001:2015 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që

operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e afatit të garancisë për pajisjet objekt prokurimi konform përcaktimit të bërë në specifikimet teknike duke nisur nga data e lëvrimit të tyre dhe gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve që vijnë për shkak të prodhimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se artikujt e ofruar janë cilësorë dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre.*

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit me objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues konform specifikimeve teknike.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike është grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Agjencia e Inteligjencës Financiare për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

SPECIFIKIMET TEKNIKE

UPS 6 KVA

Kategoria	Karakteristika	Specifikimi minimal teknik
UPS	Teknologjia	Online Double Conversion (VFI), Rack Mount, me bateri të brendshme.
UPS	Fuqia nominale	$\geq 6 \text{ kVA} / 6 \text{ kW}$
UPS	Faktori i fuqisë në dalje	≥ 1.0
UPS	Faktori Crest	$\geq 3:1$
Hyrje	Tensioni/Frekuenca	220/230 VAC, njëfazor (L+N+PE), 50 Hz
Hyrje	Diapazoni i tensionit	Jo më i ngushtë se 175–275 VAC për funksionim Online
Hyrje	Diapazoni i frekuencës	40–70 Hz (50/60 Hz nominale)
Dalje	Tensioni nominal	220/230 VAC $\pm 1\%$, 50 Hz
Dalje	Forma e valës	Sinusoidale e pastër
Dalje	Frekuenca	50/60 Hz, e sinkronizuar me hyrjen ($\pm 3 \text{ Hz}$); $\leq \pm 0.1 \text{ Hz}$ gjatë funksionimit në bateri
Dalje	Deformimi harmonik (THD)	$\leq 2\%$ në 100% ngarkesë lineare; $\leq 5\%$ në 100% ngarkesë jolineare
Dalje	Kapaciteti i mbingarkesës	$\geq 105\%$ në mënyrë të vazhdueshme; $\geq 125\%$ për të paktën 5 minuta; $\geq 150\%$ për të paktën 60 sekonda
Dalje	Koha e transferimit	0 ms
Performanca	Efikasiteti	$\geq 94\%$ në mënyrën Online Double Conversion
Performanca	ECO Mode	UPS duhet të mbështesë funksionimin në mënyrën ECO Mode.
Bateritë	Konfigurimi	Bateri të brendshme, të përfshira në UPS.
Bateritë	Autonomia	Jo më pak se 5 minuta në 100% të ngarkesës nominale.
Bateritë	Cilësia	Bateritë duhet të jenë të integruara nga prodhuesi i UPS-it, të reja dhe të prodhuara jo më herët se 12 muaj nga data e dorëzimit.
Daljet	Prizat	Minimumi 6 dalje IEC 320 C13 dhe 2 dalje IEC C19, të furnizuara nga bateria.
Funksione	Static Bypass	Automatik
Funksione	Manual Maintenance Bypass	I integruar

Kategoria	Karakteristika	Specifikimi minimal teknik
Funksione	Izolimi i modulit elektronik	UPS duhet të lejojë heqjen/shkëputjen e modulit elektronik për mirëmbajtje, pa ndërprerë furnizimin e ngarkesës dhe pa shkëputur lidhjet e hyrjes, daljes dhe bypass-it.
Funksione	Test automatik i baterive	Po, i konfigurueshëm
Funksione	Cold Start	UPS duhet të ndizet dhe të furnizojë ngarkesën nga bateria pa praninë e tensionit në hyrje.
Komunikimi	Display	Ekran LCD grafik për monitorimin e parametrave elektrikë, gjendjes së UPS-it, alarmeve dhe konfigurimit. Sinjalizim vizual dhe akustik për alarmet kryesore të funksionimit. UPS duhet të ruajë historikun e alarmeve dhe ngjarjeve (Event Log).
Komunikimi	Porta komunikimi	Ethernet 10/100/1000 me kartë SNMP v3 të integruar ose të përfshirë, USB dhe Serial.
Komunikimi	Software	Software monitorimi dhe menaxhimi të përfshirë në furnizim.
Siguria	Emergency Power Off (EPO)	UPS duhet të jetë i pajisur me funksion EPO (Emergency Power Off).
Kushtet e operimit	Temperatura	0°C deri +40°C
Kushtet e operimit	Shkalla e mbrojtjes	Minimumi IP20 ose më e mirë
Standardet	Standardet minimale	IEC/EN 62040-1; IEC/EN 62040-2; IEC/EN 62040-3. Pajisja duhet të mbajë markimin CE.
Furnizimi dhe shërbimet	Instalimi dhe testimi	Në furnizim të përfshihen transporti, instalimi, konfigurimi, testimi funksional, testimi me ngarkesë, testimi i baterive, vënia në punë dhe çdo aksesor tjetër i nevojshëm për funksionimin normal të sistemit.
Garancia	Garancia	Minimumi 3 vjet për UPS-in dhe 2 vjet për bateritë. Gjatë periudhës së garancisë, çdo defekt i pajisjes ose i baterive duhet të eliminohet ose të zëvendësohet pa kosto për Autoritetin Kontraktor.

UPS 60 KVA

Kategoria	Karakteristika	Specifikimi minimal teknik
UPS	Teknologjia	Online Double Conversion (VFI) me kabinet baterish të veçantë

Kategoria	Karakteristika	Specifikimi minimal teknik
UPS	Fuqia nominale	$\geq 60 \text{ kVA} / 60 \text{ kW}$
UPS	Faktori i fuqisë në dalje	1.0
Hyrje	Tensioni/Frekuenca	380/400 VAC, trefazor, 50 Hz
Hyrje	Diapazoni i tensionit	Jo më i ngushtë se 305–478 VAC në 100% ngarkesë
Hyrje	Diapazoni i frekuencës	46–54 Hz ose më i gjerë
Dalje	Tensioni nominal	380/400 VAC $\pm 1\%$, 50 Hz
Dalje	Forma e valës	Sinusoidale e pastër
Dalje	Deformimi harmonik (THD)	$\leq 2\%$ në 100% ngarkesë lineare; $\leq 4\%$ në 100% ngarkesë jolineare
Dalje	Kapaciteti i mbingarkesës	100–110% $\geq 60 \text{ min}$; 111–125% $\geq 10 \text{ min}$; 126–150% $\geq 1 \text{ min}$; $> 150\% \geq 200 \text{ ms}$
Dalje	Koha e transferimit	0 ms
Performanca	Efikasiteti	$\geq 95\%$ në mënyrën Online Double Conversion
Bateritë	Konfigurimi	Bankë baterish e përbërë nga jo më pak se 40 bateri 12 V / 100 Ah, ose konfigurim ekuivalent në kapacitet total sipas projektimit të prodhuesit dhe i përshtatshëm për UPS-in e ofruar.
Bateritë	Autonomia	Jo më pak se 15 minuta në ngarkesë nominale 60 kW, me bateri të reja. Autonomia duhet të vërtetohet me dokumentacionin teknik të kërkuar në seksionin “Dokumentacioni”.
Bateritë	Përputhshmëria	Bateritë duhet të jenë plotësisht të përputhshme me UPS-in e ofruar dhe të rekomanduara ose të certifikuara për përdorim nga prodhuesi i UPS-it. Përputhshmëria duhet të provohet me dokumentacionin teknik të kërkuar në seksionin “Dokumentacioni”.
Bateritë	Cilësia	Bateritë duhet të jenë të reja, të tipit Valve Regulated Lead Acid (VRLA AGM) ose teknologji ekuivalente, me jetë projektimi (Design Life) jo më pak se 10 vjet, sipas standardit EUROBAT ose standardi ekuivalent. Bateritë nuk duhet të jenë prodhuar më herët se 12 muaj nga data e prodhimit.

Kategoria	Karakteristika	Specifikimi minimal teknik
Bateritë	Kabineti	Bateritë duhet të instalohen në kabinet metalik të veçantë. Kabineti duhet të përfshijë raftet, urat lidhëse, kapikordat, siguresat, ndërprerësin e baterive, kabllot e lidhjes dhe çdo aksesor tjetër të nevojshëm për funksionimin normal të sistemit.
Funksione	Cold Start	UPS duhet të ndizet dhe të furnizojë ngarkesën nga bateria pa praninë e tensionit në hyrje.
Funksione	Static Bypass	Automatik
Funksione	Manual Maintenance Bypass	I integruar
Funksione	Lidhje në paralel	Mundësi lidhjeje opsionale në paralel me UPS të së njëjtës seri.
Komunikimi	Display	Ekran LCD grafik për monitorimin e parametrave elektrikë, gjendjes së UPS-it, alarmeve dhe konfigurimit. Sinjalizim vizual dhe akustik për alarmet kryesore të funksionimit. UPS duhet të ruajë historikun e alarmeve dhe ngjarjeve (Event Log).
Komunikimi	Porta komunikimi	Ethernet 10/100/1000 me kartë SNMP v3 të integruar ose të përfshirë, USB dhe Serial.
Komunikimi	Software	Software monitorimi dhe menaxhimi të përfshirë në furnizim.
Siguria	Emergency Power Off (EPO)	UPS duhet të jetë i pajisur me funksion EPO (Emergency Power Off).
Sistemi	Ndërprerësat	UPS duhet të ketë të integruar ndërprerësin e hyrjes, ndërprerësin e daljes, bypass-in statik, bypass-in manual për mirëmbajtje dhe ndërprerësin e bankës së baterive.
Kushtet e operimit	Temperatura	0°C deri +40°C
Kushtet e operimit	Niveli i zhurmës	≤70 dB në distancë 1 metër
Kushtet e operimit	Shkalla e mbrojtjes	Minimumi IP20 ose më e mirë
Standardet	Standardet minimale	IEC/EN 62040-1; IEC/EN 62040-2 (Category C3); IEC/EN 62040-3; Pajisja duhet të mbajë markimin CE.
Furnizimi dhe shërbimet	Instalimi dhe testimi	Në furnizim të përfshihen transporti, instalimi, konfigurimi, testimi funksional, testimi me ngarkesë, testimi i baterive, testimi i bypass-it, vënia në punë dhe çdo aksesor tjetër i nevojshëm për funksionimin normal të sistemit.

Kategoria	Karakteristika	Specifikimi minimal teknik
Garancia	Garancia	Minimumi 3 vjet për UPS-in dhe minimumi 2 vjet për bateritë. Gjatë periudhës së garancisë, çdo defekt i pajisjes ose i baterive duhet të eliminohet ose të zëvendësohet pa kosto për Autoritetin Kontraktor.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT